



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 4873/1 Prot  
Dt. 15.08.25



Nr. 5601  
prot.

Shkodër, më. 10.09.2025

Lënda: Mbi Vendimet Nr. 49, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", Urdhërit të Prefektit për delegim Nr.62, datë 28.08.2025, të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", neni 54, shkronjat "II", neni 55, pika 2, neni 64, shkronja "c", shkresës së KB Vau Dejës nr.487/1 prot, datë 3.9.2025, u njoh me Vendimin Nr. 49, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës "Për emërtim rrugë "Zef Tanushi", akt me karakter jo normativ.

Ky akt nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja "a" e ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin" i ndryshuar, ka detyrim të shprehët.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T**

**Majlinda ANGONI**

**NË MUNGESË DHE DELEGIM**

**NËNPREFEKTI**

**Hysen HYSAJ**





**BASHKIA VAU DEJËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D I M**

Nr. 49 datë 29.08. 2025

**“Për ndryshimin emërtimin e një segmenti të një rruge në Lagjen Mllojë, Bashkia Vau Dejës, me emrin e propozuar “ZEF TANUSHI”, Lagja Mllojë, Bashkia Vau Dejës”.**

Mbështetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 20, neni ( Neni 20: **E drejta e iniciativës qytetare** .1.Çdo komunitet,nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij,ose jo më pak se një përqind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë Brenda juridiksionit tqë njesisë së vetëqeverisjes vendore), **neni 23**, (Neni 23: Funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, pika 4. Ndërtimin ,rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimin rrugor,të trotuarëve dhe shesheve publike vendore.) **neni 54** (Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, germall), **vendos për emërtimin e rrugëve,shesheve terrioreve,intitucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë**), ligji nr.9270,datë 29.07.2004 ‘Për sistemin e adresave’ ndryshuar, **Neni 3. Emërtimi I bulevardeve,rrugëve,rrugicave ,shesheve dhe parqeve bëhet me vendim të këshillit të njësisë të vetëqeverisjes vendore,nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen.** Neni 4/1 ( shtuar me ligjin nr.9951,datë.10.07.2008) **1. Cdo njësi e qeverisjes vendore krijon,përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave.** Shkresen e Ministrisë së Brendshme Nr.419 Prot date 11.02.2020,Shkresen e Ministrisë së Brendshme nr.3067 ,datë 07.12.2020,si dhe nisur nga kërkesat e Organiztës së Veteranëve,Bashkia Vau Dejës,Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI:**

1.Të ndryshohet emërtimi i segmentit të rrugës gjatësi 360 ml, sipas hartës bashkelidhur:

| Nr. Rruge | Emri i rrugës është: | Vendoset    |
|-----------|----------------------|-------------|
| 03360068  | MLLOJE               | ZEF TANUSHI |

2.Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kadastres dhe Investimeve Publike për zbatimin e vendimit.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”(ndryshuar)

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratur me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 03.09.2025



Kryetar i Këshillit Bashkiak

Ervis Shimag



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT,KADASTRËS**  
**DHE INVESTIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vau Dejes, më \_\_\_\_\_, 2025

**Projekt – Propozim**  
**Nr. 1      Date : 21 / 08 2025**

**Për ndryshimin emërtimin e një segmenti të një rruge në Lagjen Mllojë , Bashkia Vau Dejes ,me emrin e propozuar “ZEF TANUSHI”,Lagjia Mllojë, Bashkia Vau Dejes.**

*Mbështetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”neni 20,neni ( Neni 20: E drejta e iniciativës qytetare ,1.Çdo komunitet,nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij,ose jo më pak se një përqind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë Brenda juridiksionit tëqë njesisë së vetëqeverisjes vendore), neni 23,(Neni 23: Funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, pika 4. Ndërtimin ,rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimin rrugor,të trotuarëve dhe shesheve publike vendore.) neni 54 (Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, germall), vendos për emërtimin e rrugëve,shesheve territoreve,intitucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë), ligji nr.9270,datë 29.07.2004 ‘Për sistemin e adresave’ ndryshuar, Neni 3. Emërtimi I bulevardeve,rrugëve,rrugicave ,shesheve dhe parqeve bëhet me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore,nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen. Neni 4/1 ( shtuar me ligjin nr.9951,datë.10.07.2008) 1. Cdo njësi e qeverisjes vendore krijon,përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave. Shkresen e Ministrisë së Brendshme Nr.419 Prot date 11.02.2020,Shkresen e Ministrisë së Brendshme nr.3067 ,datë 07.12.2020,si dhe nisur nga kërkesat e Organiztës së Veteranëve,Bashkia Vau Dejes,që propozojnë ndryshimin/rregullimin e emërtimit e një segmenti rruge në lagjen Mllojë.*

**PROPOZOJME**

Si dhe pas shqyrtimit të kërkesës së banorëve ku rezulton se rruga “MLLOJE” të ciles kërkohet ti ndryshohet emërtimi është një segment rruge me gjatësi 360 ml, sipas hartes bashkelidhur. Të ndryshohet emërtimi i segmentit te rrugës:

| Nr. Rruge | Emri i rruges eshte: | Propozohet: |
|-----------|----------------------|-------------|
| 03360068  | MLLOJE               | ZEF TANUSHI |

Bashkelidhur kërkesa e banoreve, dhe harta përkatëse.

**KRYETAR**  
**KRISTIAN SHKRELI**

**ME VENDIM DELEGIMI**

**ZV/KRYETARE**

**ALEKSANDRA GJONI**



*Juriste : Dorina Lekaj*

*Ing: Armand Velaj*

*Specialist/Juriste: Mirela Lum*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT, KADASTRËS DHE INVESTIMEVE  
PUBLIKE

Nr.        prot.

Vau Dejes, më 21.08.2025

**Lenda : Relacion sqarues " Mbi ndryshimin e emertimit të një segmenti të rrugës në lagjen Millojë , Bashkia Vau Dejes".**

Pranë Bashkisë Vau Dejes, kanë paraqitur kërkesë Organizata e Veteranëve e Pasardhësve "LANC", Bashkia Vau Dejes, ku kanë kërkuar ndryshimin/rrregullimin e emertimit të një segmenti rruge në lagjen Millojë dhe këtij segmenti propozojnë t'i vihet emri i dëshmorit të atdheut Zef Pjetër Tanushi. Gjithashtu pranë Bashkisë Vau Dejes është paraqitur banori Zef Tanushi i cili ka shprehur dëshirën për emëtimin e këtij segmenti rruge, pasi ka trashëguar emrin e gjyshit të tij Zef Pjetër Tanushi. Rruga është një rrugice e cila nuk ka dalje, me gjatësi 360 m e cila rezulton e emërtuar rruga Millojë aktualisht dhe sipas kërkesës së Organizatës së Veteranëve e Pasardhësve "LANC", t'i vihet emri ZEF TANUSHI.

Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka drejtuar një shkresë zyrtare kundrejt Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit ku ka kërkuar informacion mbi verifikimin e pastërtisë për Zef Pjetër Tanushi në kuadër të propozimit për emëtimin e kësaj rruge, nga e cila na është informuar dhe sqaruar nga Autoriteti si më poshtë vijon:

*Mbi baza të dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera deri tani referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni kërkuar, për Zef Tanushi, nuk rezulton të ketë materiale në emër të tij, sipas Nenit 30, të ligjit nr.45/2015, 'Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë', i ndryshuar.*

Gjithashtu sqarojme se Bashkia Vau Dejes, ka ndërhyrë për ndryshim emërtimi të rrugëve edhe në raste të tjera pasi ka marrë anketa nga banorët për emërtime të rrugëve me emra që banorët as nuk e dinin dhe nga vete fshati apo lagjia emërtohej me një tjetër emër.

Kjo ka ndodhur kryesisht kur në vitin 2011 INSTAT ka realizuar Censurin e Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, dhe në vijim kur u bë bashkimi i Sistemit të Adresave me Sistemin e Gjendjes Civile në të gjithë Republikën e Shqipërisë ka ndodhur fenomeni i mosperputhjes së adresave të banorëve me pasaportizimin e gjendjes civile, ku ka rezultuar një koplaps për gjithë adresat e banorëve të cilët jetojnë apo punojnë në një qytet tjetër apo Bashki tjetër nga ajo ku kanë Gjendjen Civile.

Duke qënë se censi i ka gjetur në një zonë të caktuar u ka dërguar automatikisht edhe adresën aty.

Të ndodhur në këto rrethana, dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr 9270 datë 29.07.2004 ndryshuar si dhe nga shkresa e Ministrisë së Brendshme Nr. 419 Prot datë 11.02.2020, ka nisur puna intensive nga Gjendja Civile si dhe nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit ku është ngritur struktura për Menaxhimin dhe Sistemin e Sistemit të Adresave nga ing. përkates.

Ndryshimi dhe sistemimi i adresave bëhet kur banori paraqitet në Institucion me dokument identifikimi apo pronësie, dhe gjatë procedurës ka rezultuar se shumë lagje mbajnë emërtime për të cilat banorët nuk i njohin dhe nuk bien dakort, dhe kërkojnë të vendosen emërtimet e rrugëve siq ata i njohin prej shumë kohësh.

Konc. Mirela Lumi

# Lista e banorëve të lagjes

1. Gjirim Hamka
2. Gula P. osku
3. Gjovaleim Pnenoli
4. Luendro Luvri
5. GEBIM MIKAY
6. ASTRIT MIKAT
7. FILE MIKAY
8. MYHER MIKAY
9. GENTJA MIKAY
10. Smajl GEGE
11. Pol
12. Hozbi Terziu
13. Lule Hathi
14. Elim toshi
15. BILHAR TRAPI
16. Pjeter gjoka
17. ZSK GOKA
18. Mir trapi
19. Mark Gjuri
20. Musa Musa
21. Fep Iam Iamur
22. Sell Iam Iamur
23. Hal Iam Iamur
4. Kuviri

29. SHUKRI ELI  
30. Pjerin Luka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 345/0 Prot.

Tiranë, më 24.04.2025

**V E N D I M**

Nr. 226 Datë 24.04.2025

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 24.04.2025, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

|                   |        |
|-------------------|--------|
| Z. Albert Nikolla | Anëtar |
| Z. Altin Hoxha    | Anëtar |
| Z. Gjergj Marku   | Anëtar |
| Z. Skënder Vrioni | Anëtar |

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:**

Kërkesa e paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Vau Dejës, me shkresën nr. 1085/1 prot., datë 25.03.2025, "Kërkesë për informacion", për verifikimin e figurës së z. Zef Tanushi, në kuadër të propozimit për emërtimin e një hapësire publike.

**BAZA LIGJORE:**

Ligji nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi kërkesën për informacion të paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Vau Dejës, me shkresën nr. 1085/1 prot., datë 25.03.2025, sipas objektit të saj,

**V Ë R E N:**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Në nenin 10, pika "dh" të Ligjit nr. 45/2015, një nga detyrat e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është edhe informimi i individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.

Nga përmbajtja e shkresës nr. 1085/1 prot., datë 25.03.2025, "Kërkesë për informacion", Institucioni i Bashkisë Vau Dejës, në zbatim të detyrimeve ligjore që rjedhin nga Ligji nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ka kërkuar Autoritetit nëse disponon informacion, lidhur me z. Zef Tanushi, në kuadër të propozimit për emërtimin e një hapësire publike, me përmbajtje sipas shkresës së dërguar nga Bashkia Vau Dejës.

Mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera deri tani referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni kërkuar, për z. Zef Tanushi, nuk



figuron të ketë materiale në emër të tij, sipas Nenit 30, të Ligjit Nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funkionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

### VENDOSI

1. Të informojë Institucionin e Bashkisë Vau Dejës, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 1085/1 prot., datë 25.03.2025, "Kërkesë për informacion", në kuadër të propozimit për emërtimin e një hapësire publike, se nga verifikimet e kryera deri tani, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar rezulton se z. Zef Tanushi;

a) Nuk ka qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese posaçme politike, apo punonjës i nivelit të lartë i ish-Sigurimit të Shtetit;

b) Nuk ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, denoncues në proceset politike ose dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, pas mbushjes së moshës 18 vjeç;

c) Nuk ka qenë person me të dhëna nga ish-Sigurimi i Shtetit për spiunazh dhe terrorizëm.

2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Bashkisë Vau Dejës.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

### KRYETARJA

**Dr. Gentiana Sula**

**Në mungesë dhe me Urdhër**

**ANËTAR**

**Alfin Hoxha**

**ANËTAR**

**Gjergj Marku**

**ANËTAR**

**Skënder Vroni**

**ANËTAR**

**Dr. Albert Nikolla**